



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KOMISIONERËT PUBLIKË

Nr. \_\_\_\_\_ prot.

Tiranë, më 26.7.2021

**Lënda:** Parashtrime të Komisionerit Publik, në seancën gjyqësore të datës 26.7.2021, para trupit gjykues të Kolegjit të Posaçëm të Apelit, në çështjen ankim kundër vendimit nr. 324, datë 11.12.2020, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, për subjektin e rivlerësimit z. Sokol Ngresi

**Baza ligjore:** Neni 179/b, pika 5 e Kushtetutës, neni C, pika 2, neni F, pika 2 e aneksit të Kushtetutës, neni 63 i ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”

**Drejtuar:** Kolegjit të Posaçëm të Apelit

Të nderuar anëtarë të trupit gjykues,

1. Në seancën e datës 7.7.2021, bazuar në nenin F të aneksit të Kushtetutës dhe në nenin 45 të ligjit nr. 84/2016, në kuadër të shqyrtimit të çështjes objekt ankimi, trupi gjykues i Kolegjit vendosi që të kryejë hetime të mëtejshme mbi disa denoncime, ku pretendohet për një pasuri të padeklaruar nga ana e subjektit të rivlerësimit. Në funksion të hetimit, Kolegji vendosi:

- (i) T’i kërkojë informacion përshkruar dhe akte shoqëruese shoqërisë “\*\*\*\* \*\*\*\*” sh.p.k., lidhur me kontratën nr. \*\*\* rep., datë \*\*\*.2.2014, mandatet e arkëtimit të pretenduara në denoncim si të nënshkruara prej subjektit të rivlerësimit, si dhe informacion mbi statusin aktual ligjor të pasurisë së përshkruar në kontratë, gjendjen fizike dhe pronësinë mbi të;
- (ii) Të kërkojë informacione shtesë sqaruese nga Agjencia Shtetërore e Kadastrës, Drejtoria Vendore Vlorë mbi pasurinë e përshkruar në kontratën nr. \*\*\* rep., datë \*\*\*.2.2014, si dhe për objektin e ndërtuar në zbatim të lejes së ndërtimit, të miratuar me vendim të KRRT-së së Bashkisë Vlorë nr. \*\*\*\*/\*\*\*\*, datë \*\*\*.2.2009;
- (iii) T’i kërkojë informacion ILDKPKI-së për mënyrën dhe praktikën e ndjekur nga ky institucion për vënien në dispozicion të modeleve të deklaratave të interesave private të subjekteve deklaruese, për periudhën 2007 deri 2010;

(iv) T'i kërkojë informacion shoqërisë "\*\*\*\*" sh.p.k. në lidhje me kontratën noteriale nr. \*\*\* rep. dhe nr. \*\*\* kol., të datës \*\*\*.8.2007, lidhur ndërmjet kësaj shoqërie dhe subjektit të rivlerësimit, Sokol Ngresi, prishjen e saj dhe kthimin e palëve në gjendjen e mëparshme.

2. Kolegji i Posaçëm i Apelimit, me shkresën nr. \*\*\*\*/\*\*\*\* prot., datë \*\*7.2021, ka përcjellë shkresën nr. \*\*\*\*/\*\*\*\* regj., datë \*\*\*7.2021, të gjyqtares kryesuese të çështjes (JR) nr. 12/2021, që i përket ankimit të Komisionerit Publik kundër vendimit nr. 324/2020, bashkëlidhur së cilës janë përcjellë kopje të njësuara me vulën e sekretarisë, së Kolegjit të Posaçëm të Apelimit, të përgjigjeve të marra nga shoqëritë private dhe entet publike, si vijon:

- Shkresa e shoqërisë "\*\*\*\* \*\*\*\*" sh.p.k. dhe aktet bashkëlidhur saj (31 fletë);
- Shkresa e ILDKPKI-së me nr. \*\*\*\*/\*\*\*\* prot., datë \*\*\*7.2021 (2 fletë);
- Shkresa e shoqërisë "\*\*\*\*" sh.p.k. dhe aktet bashkëlidhur saj (48 fletë);
- Denoncim i administruar në Kolegj pas seancës gjyqësore publike të datës 7.7.2021, i sjellë nga \*\*\* \*\*\*, \*\*\*, \*\*\*, \*\*\*, \*\*\*, \*\*\*, \*\*\*, \*\*\*, i regjistruar në Kolegj me nr. \*\*\* prot., datë \*\*\*7.2021.

3. Lidhur me shkresën e shoqërisë "\*\*\*\* \*\*\*\*" sh.p.k.<sup>1</sup>, administratori i shoqërisë, z. \*\*\* \*\*\*, konfirmon se:

(i) Shoqëria ndërtuese "\*\*\*\* \*\*\*\*" sh.p.k. ka lidhur "Kontratë paraprake për shitje të pasurisë së paluajtshme", nr.\*\*\* rep., datë \*\*\*2.2014, me subjektin e rivlerësimit, z. Sokol Ngresi, me vlerë 68.000 euro, nga të cilat sipas mandat-arkëtimeve, deri më datë 29.9.2014, janë likuiduar nga subjekti i rivlerësimit 20.000 euro.

(ii) Kjo kontratë është revokuar me deklaratë për revokim kontrate prenotimi nr.\*\*\* rep., datë \*\*\*4.2015, me deklarues z. \*\*\*.\*\*\*., në cilësinë e administratorit të shoqërisë "\*\*\*\* \*\*\*\*" sh.p.k., dhe subjektit të rivlerësimit. Shoqëria ndërtuese "\*\*\*\* \*\*\*\*" sh.p.k. i ka kthyer subjektit shumën e paguar 20.000 euro me mandat pagesë nr.\*\*\*, datë \*\*\*4.2015, duke i kthyer palët në gjendjen e mëparshme.

(iii) Aktualisht pasuria e përshkruar në kontratën e prenotimit është në titull pronësie të shoqërisë "\*\*\*\* \*\*\*\*" sh.p.k.

3.1 Lidhur me formën e akteve të sipërcituara, administratori ka sqaruar se ato nuk janë lidhur te noteri, pasi ndërmjet tij dhe subjektit të rivlerësimit ka pasur marrëdhënie shoqërore.

3.2 Bashkëngjitur kësaj shkrese janë paraqitur: (i) kopje kontrate paraprake nr.\*\*\* rep., datë \*\*\*2.2014; (ii) tri mandate arkëtimi; (iii) deklaratë nr.\*\*\* rep., datë \*\*\*4.2015, për revokim

<sup>1</sup> Pranë Institucionit të Komisionerëve Publikë, në datën \*\*\*7.2021, është administruar e njëjta shkresë kthim përgjigje e Shoqërisë "\*\*\*\* \*\*\*\*" sh.p.k. dhe aktet bashkëlidhur me të njëjtën përmbajtje.

kontrate prenotimi; (iv) mandat pagese i shoqërisë “\*\*\*\* \*\*\*\*” sh.p.k., nr.\*\*\*, datë \*\*\*.4.2015; (v) kartelë pasurie e paluajtshme për pasurinë nr. \*\*\*/\*\*\*+\*\*\*\_\*\*\*/\*\*\*, z. k. \*\*\*, për apartament me sip.105.52 m<sup>2</sup>; (vi) Komunikim me *email*, i dërguar në datën \*\*\*.4.2015, nga adresa elektronike: [\\*\\*\\*\\_\\*\\*\\*@\\*\\*\\*.com](mailto:***_***@***.com), në adresën elektronike të administratorit të shoqërisë: [\\*\\*\\*\\_\\*\\*\\*@\\*\\*\\*.com](mailto:***_***@***.com); (vii) Ankim i shoqërisë “\*\*\*\* \*\*\*\*” sh.p.k., kundër vendimit nr. \*\*\*, datë \*\*\*.4.2015, të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë.

3.3 Komisioneri Publik, duke i analizuar këto shkresa private në raport me deklaratimet e administratorit të shoqërisë, referuar nenit 246 e vijues të K. Pr. C., konstaton se subjekti i rivlerësimit ka porositur te shoqëria “\*\*\*\* \*\*\*\*” sh.p.k. një apartament me sip. 113,43 m<sup>2</sup> dhe sip. verande 95,46 m<sup>2</sup> me vlerë 68.000 euro, sipas “Kontratë paraprake për shitje të pasurisë së paluajtshme”, me nr.\*\*\* rep., datë \*\*\*.2.2014. Për këtë apartament, sipas madat-pagesave, rezulton se deri në datën \*\*\*.9.2014 është likuiduar në total shuma 20.000 euro. Bazuar në dokumentacionin e përcjellë nga shoqëria, kjo kontratë është revokuar, palët janë kthyer në gjendjen e mëparshme dhe shoqëria “\*\*\*\* \*\*\*\*” sh.p.k. ka kthyer të gjithë shumën e paguar, prej 20.000 euro, me mandat pagese nr.\*\*\*, datë \*\*\*.4.2015.

4. Ndërkohë, referuar shkresës së ILDKPKI-së nr. \*\*\*/\*\*\* prot., datë \*\*\*.7.2021, konfirmohet se për periudhën e kërkuar, vitet 2007-2010, kanë qenë në fuqi modelet e deklaratave të interesave private të miratuara me urdhrin nr. 36, datë 10.10.2016, të Inspektorit të Përgjithshëm<sup>2</sup>, si dhe me urdhrin nr. 77, datë 26.12.2008, të Inspektorit të Përgjithshëm<sup>3</sup>. Modelet e deklaratave në fuqi, përveç publikimit në fletoret zyrtare respektive, kanë qenë të publikuara dhe të aksesueshme *online* edhe në faqen zyrtare të internetit të Inspektoratit të Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive. Për periudhën 2007-2008, nga ILDKPKI, janë marrë masa dhe për shpërndarjen e kopjeve fizike të deklaratave të interesave private pranë institucioneve publike, zyrtarët e të cilave ishin subjekte deklaruese.

4.1 Komisioneri Publik, bazuar në përmbajtjen e kësaj shkrese, vlerëson se pretendimet e subjektit të rivlerësimit në kundërankimin<sup>4</sup> e tij, datë 1.3.2021, dhe në seancën para Kolegjit, të datës 7.7.2021, nuk gjejnë mbështetje edhe referuar sa është parashtruar nga ILDKPKI-ja.

5. Lidhur me shkresën e shoqërisë “\*\*\*\*” sh.p.k., z. \*\*\* \*\*\*, në cilësinë e ortakut të shoqërisë (50% të kuotave), konfirmon se, sipas administratorit të kohës, z. \*\*\* \*\*\*, me subjektin e rivlerësimit është lidhur kontrata nr. \*\*\* rep., datë \*\*\*.8.2007, për prenotimin e një apartamenti me sipërfaqe 84 m<sup>2</sup>. Me firmosjen e kontratës nga subjekti i rivlerësimit janë paguar 17.000 euro, ndërsa pjesa tjetër, prej 16.000 euro, është paguar me kredi bankare. Më

<sup>2</sup> Botuar në Fletoren Zyrtare nr. 109, datë 16.10.2006.

<sup>3</sup> Botuar në Fletoren Zyrtare nr. 188, datë 29.12.2008.

<sup>4</sup> Në faqet 13-14 të kundërankimit, ndër të tjera, subjekti pretendon se: [...]... *mosevidentimi i kësaj shume në deklaratën e rifillimit të detyrës nuk është as për shkak pakujdesie, por për formatin e vetë deklaratës, që më është vënë në dispozicion nga ky institucion [...].*

tej në këtë shkresë, ky shtetas konfirmon se me zgjidhjen e kontratës, z. Ngresi i është kthyer e gjithë shuma e paguar, duke mos pasur asnjë pretendim prej tij. Revokimi i kontratës nuk është bërë para noterit, për të ulur kostot e panevojshme. Sipas z. \*\*\*, ish-administratori, z. \*\*\*, i ka konfirmuar se pjesa që i ka kaluar me bankë i është kthyer subjektit po përmes bankës, ndërsa pjesa e paguar *cash* është kthyer në të njëjtën mënyrë.

5.1 Në vlerësimin e Komisionerit Publik, edhe pse deklarohet kthimi i shumës prej 17.000 euro, nga shoqëria “\*\*\*\*” sh.p.k., mbetet i paprovuar posedimi i kësaj shume në *cash* nga subjekti i rivlerësimit, për sa kohë subjekti nuk ka deklaruar kthimin/posedimin e kursimeve *cash* sipas detyrimit të parashikuar në ligjin nr. 9049/2003 (i ndryshuar).

6. Lidhur me denoncimin e z. \*\*\* \*\*\*, Sekretar i Përgjithshëm i \*\*\*\* \*\*\*, \*\*\*\* \*\*\*, \*\*\*\* \*\*\*, \*\*\*\* \*\*\*, denoncuesi ankohet se trupi gjykues, ku subjekti ka qenë në cilësinë e anëtarit, ka vendosur, në kundërshtim me ligjin penal dhe procedural, në dhënien e vendimit nr. \*\*\*, datë \*\*\*.6.2015, të Gjykatës së Apelit Vlorë. Ky pretendim ka qenë administruar edhe në dosjen e Komisionit, si pjesë e denoncimit që kjo sindikatë ka paraqitur në Komision, dhe ka gjetur trajtim.

7. Pas seancës gjyqësore të datës 7.7.2021, në adresën elektronike të Institucionit të Komisionerëve Publikë: [info@ikp.al](mailto:info@ikp.al), kanë ardhur dy denoncime për subjektin e rivlerësimit, z. Sokol Ngresi, si vijon:

7.1 Ankim i shtetasit \*\*\* \*\*\*, i datës \*\*\*.7.2021, ndaj subjektit të rivlerësimit për mosdeklarim pasurie dhe veprime në kundërshtim me ligjin. Në këtë ankim, z. \*\*\* pretendon se gjyqtari ka përfituar një pasuri nga shoqëria “\*\*\*\* \*\*\*” sh.p.k., në këmbim të një vendimi të padrejtë kundër tij, në çështjen gjyqësore që ky denoncues kishte me këtë shoqëri ndërtuese, pranë Gjykatës së Apelit Vlorë. Bashkëngjitur këtij *email*-i, denoncuesi ka paraqitur: *i*) Vendim i Gjykatës së Apelit Vlorë nr. \*\*\*, datë \*\*\*.3.2014; *ii*) tri kontrata prenotim shitje<sup>5</sup> të denoncuesit, të lidhura me shoqërinë “\*\*\*\* \*\*\*” sh.p.k.; *iii*) rekurs i denoncuesit në Gjykatën e Lartë; *iv*) fotokopje nga faqja zyrtare e Gjykatës së Lartë, ku çështja e denoncuesit me shoqërinë “\*\*\*\* ” sh.p.k. pret për t’u gjykuar.

7.2 Denoncim nga adresa e *email*-it: [\\*\\*\\*\\*\\*@\\*\\*\\*\\*.com](mailto:*****@****.com), i datës \*\*\*.7.2021, në të cilin denoncuesi pretendon se kontrata paraprake, nr.\*\*\* rep. datë \*\*\*.2.2014, e nënshkruar nga subjekti me shoqërinë “\*\*\*\* \*\*\*” sh.p.k., është origjinale dhe, njëkohësisht, subjekti i rivlerësimit ka qenë avokat i shoqërisë ndërtuese “\*\*\*\* \*\*\*” sh.p.k., duke bërë avokatinë e kësaj shoqërie, madje edhe kur ka qenë në funksionin e gjyqtarit, fakt ky i njohur në qytetin e Vlorës. Bashkëlidhur këtij *email*-i, denoncuesi ka paraqitur: *i*) kopje kontrate paraprake, nr.

<sup>5</sup> (i) Kontratë prenotim shitje apartamenti, nr. \*\*\* rep., datë \*\*\*.9.2002; (ii) Kontratë prenotim shitje dyqani, nr. \*\*\* rep., datë \*\*\*.2.2003; (iii) Kontratë prenotim shitje garazhi, nr. \*\*\* rep., datë \*\*\*.11.2003.

\*\*\* rep. datë \*\*\*.2.2014, nënshkruar nga z. Sokol Ngresi, në cilësinë e blerësit, dhe shoqërisë “\*\*\* \*\*\*” sh.p.k., në cilësinë e sipërmarrësit, së bashku me planimetrinë e sheshit të ndërtimit; ii) Leje ndërtimi, lëshuar nga KRRT, Bashkia Vlorë, datë \*\*\*.3.2011; iii) tri mandate arkëtimi, të njëjta me ato të paraqitura dhe në denoncimet e mëparshme.

**KOMISIONERI PUBLIK**

**Florian BALLHYSA**

[Shqiptaria.com]